



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25 Prill 2023

Nr: 412

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 246, 284, 285, TË MONITORUESIT, QENDRËS “QËNDRESA QYTETARE” DHE ORGANIZATËS “KOMITETI SHQIPTARË I HELSINKIT” NDAJ KRYETARIT TË BASHKISË KORÇË DHE PERSONIT PËRGJEGJËS PËR BASHKINË KORÇË, PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË PUBLIKE TË NDALUAR NGA KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE DHE PËRDORIMIN E BURIMEVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 25 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Shoqata “Komitetit Shqiptar i Helsinkit”;
Qendra “Qëndresa Qytetare”;
Monitoruesi;

SUBJEKT: Z. Sotiraq Filo, kryetari bashkisë Korçë;
Zj. Mariana Jorgji, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë;
Z. Luis Qirinxhi, administrator i “Qendra Sportive Korçë” sh.a.

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Korçë për zhvillimin e veprimtarisë publike të ndaluar dhe shkeljeve .

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 25 Prill 2023

Nr: 412

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj kryetarit të bashkisë Korçë dhe personit përgjegjës në bashkinë Korçë”

KONSTATOJ:

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë administruar 2 (dy) denoncime dhe 1 (një) raport monitorimi, të cilat denoncojnë zhvillimin e një aktiviteti i vlerësuar si “I ndaluar nga KQZ-JA” për bashkinë Korçë. Denoncimet janë administruar nëpërmjet shkresave:

- 1- Raporti i monitorimit, identifikuar me kod unik raporti 9534481, protokolluar me nr. 3414 prot., datë 03.04.2023, e regjistruar me nr. **246 ID**, ku pretendohet se *“Në datën 1 Prill 2023, është monitoruar takimi prezantues i kandidatit për kryetar bashkie Korçë z. Sotiraq Filo, kandidat i Partisë Socialiste dhe kryetar i bashkisë Korçë. Takimi ka filluar në orën 11:10 dhe ka zgjatur deri në orën 12:50. Në këtë takim kanë qënë përfaqësues të Këshillit të Ministrave, konkretisht Ministri z. Niko Peleshi, i cili është drejtuesi politik i Partisë Socialiste për Qarkun Korçë, anëtarët e parlamentit z. Ilir Pendavinji dhe zj. Enslemvera Zake, të cilët janë deputetë të kësaj force politike. Në takim kanë qënë prezent dhe drejtuesja e këshillit të Qarkut Korçë zj. Ana Verushi. Në takim kanë marrë pjesë dhe drejtorët e agjencive të linjave të ministrive për bashkinë Korçë”. Takimi është mbajtur në mjediset e “Qytezës së Fëmijëve”, një hapësirë publike nën administrimin e bashkisë Korçë.”*
- 2- Shkresa e datës 6.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3611 prot., datë 11.04.2023, me kërkues qendrën “Qëndresa Qytetare”, e regjistruar me nr. **284 ID**, ku pretendohet se *“ Më datë 31 Mars 2023, bashkia Korçë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një veprimtari publike me objekt ‘Takim prezantues me asamblenë e zgjeruar’, raportuar më datë 31.3.2023, për t’u zhvilluar në datë 1.4.2023 ora 11:00, me vend zhvillimi në Korçë, me folës kryesorë: z. Sotiraq Filo (Kryetar i Bashkisë Korçë), pjesëmarrësit: i deleguari politik i qarkut Korçë z. Niko Peleshi, anëtarë të asamblesë së zgjeruar, deputetë të qarkut Korçë, pjesëmarrës të tjerë. Në orën 19:00, të së njëjtës datë, me vendimin nr.231, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi ndalimin e zhvillimit të saj. Pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja të këtij aktiviteti, sërish ai është mbajtur në ambientet e Qëndres Sportive Korçë, me vendndodhje në Rrugën “Niko Kovaçi”, pranë Qytezës së Fëmijëve. Ky aktivitet është shpërndarë në faqen e Z. Sotiraq Filo, aktualisht kryetar i bashkisë Korçë dhe njëherazi, kandidat i Partisë Socialiste për kryetar bashkie në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Në fjalën e tij, z. Filo dëgjohet të shprehet mbi natyrën politike dhe partiake të aktivitetit, duke falenderuar Partinë Socialiste për besimin në personin e tij dhe duke u shprehur se Partia Socialiste do të arrijë rezultatin më të mirë ndonjëherë në bashkinë Korçë. Njëherazi, aktiviteti ka gjetur mbulim në rrjetet sociale të drejtuesit politik të Partisë Socialiste për qarkun e Korçës, njëherazi dhe Ministër i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi. Veprimtaria publike është zhvilluar në ambientet e “Qendrës Sportive Korçë”, të cilat janë në pronësi dhe administrim të shoqërisë “Qendra Sportive Korçë” sh.a., e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 13.09.2018, me NUIS L84513003Q. Kjo shoqëri aksionare si*

aksionar të vetëm ka bashkinë e Korçës. Përsa më sipër, në rastin konkret, provohet tërësisht përmbushja e këtij kushti pasi veprimtaria është zhvilluar në ambientet që janë në pronësi dhe administrim të një enti ku bashkia Korçë zotëron 100% të aksioneve të kapitalit.”

- 3- Nëpërmjet shkresës nr. 250 prot., datë 7.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3614 prot., datë 11.04.2023, me kërkues shoqatën “Komiteti Shqiptar i Helsinkit”, e regjistruar me **nr. 285 ID**, ku pretendohet se “Pranë Komitetit Shqiptar të Helsinkit ka mbërritur një sinjalizim nga një qytetar i bashkisë Korçë, i cili pretendon se më datë 1.4.2023, kandidati për kryetar të bashkisë Korçë, z. Sotiraq Filo, ka realizuar aktivitetin me temë “Takim me Asamblenë e Zgjeruar të PS të Korçës”. Më herët ky aktivitet, me anë të vendimit nr. 231, datë 31.3.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është konsideruar si veprimtari e ndaluar sepse bie ndesh me nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Denoncuesit kërkojnë hetimin e rastit dhe marrjen e masave administrative për personat përgjegjës të kësaj shkelje.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Mëqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nga kërkues të ndryshëm dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore dhe kanë për subjekt kryetarin e bashkisë Korçë, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Për t'i ardhur në ndihmë hetimit administrativ të këtyre denoncimeve, administrata e Komisionit Qendror të zgjedhjeve ka administruara aktet e mëposhtme:

- 1- Vendimin nr. **231, datë 31.03.2023** "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të bashkisë Korçë" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- 2- Njoftim për ndalimin e veprimtarisë së raportuar në ndërfaqen e KQZ, nga bashkia Korçë, i datës **31 Mars 2023, ora 7:34 PM**. Rezultoi se vendimi nr. 231 datë 31.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i është njoftuar personit përgjegjës për raportim të Bashkisë Korçë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- 3- Kërkesa e brendshme e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për caktimin e monitoruesit", datë **31.03.2023, ora 9: 17 PM** për ndjekjen e rastit.

Në vijim të hetimi administrativ, referuar raportiti të monitoruesit të ardhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, jemi sinjalizuar se ambientet e përdorura për zhvillimin e aktivitetit janë në pronësi të bashkisë Korçë. Më datë **5.4.2023**, nëpërmjet adresës së postës elektronike i është kërkuar informacion bashkisë Korçë për "

- Çfarë statusi ligjor kanë ambientet e "Qyteza e Fëmijëve"?
- Nga kush administrohen këto ambiente dhe sqaroni nëse mundet të jepen me qira për aktivitete, që nuk janë të lidhura më fëmijët?
- Nëse ambientet e kësaj qendre jepen me qira, për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, ju lutemi, paraqisni kontratën e qirasë dhe faturën e paguar nga subjekti qiramarrës.

Bashkia Korçë ka sqaruar se: "Ambientet e "Qytezës së Fëmijëve" janë në administrim të Qendrës Sportive Korçë sh. a, shoqëri aksionare identifikuar me Nuis: L84513003Q, me aksionar 100% bashkia Korçë (këshilli bashkiak Korçë). Sipas objektit të aktivitetit të kësaj shoqërie, ambientet e saj mund të përdoren për çdo lloj aktiviteti, jo vetëm ato që kanë lidhje me fëmijët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas tarifave të miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak Korçë. Partia Socialiste ka marrë me qira ambientet, për zhvillim aktiviteti, sipas faturës bashkëlidhur, bazuar në tarifën e miratuara në Këshillin Bashkiak"

Më datë **06.04.2023**, nëpërmjet adresës së postës elektronike personi përgjegjës mbi raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë, i është kërkuar informacion ndër të tjera bën me dije se:

"Kryetari i bashkisë Korçë është informuar në lidhje me vendimin nr. 231, datë 31.03.2023, "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Korçë" të KQZ-së dhe bashkia nuk ka zhvilluar asnjë veprimtari të ndaluar nga Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr.231, datë 31.03.2023.

Veprimtaria është zhvilluar nga Partia Socialiste, ku kryetari ka marrë pjesë si i ftuar në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie.

Përsa i përket raportimit të kësaj veprimtarie në ndërfaqen e KQZ-së, sqarohet se është bërë një gabim material njerëzor në raportim nga punonjësi i bashkisë i ngarkuar me detyrën e raportimit”.

Më datë **11.04.2023**, është regjistruar denoncimi me **nr. 284 ID**, me kërkues qendrën “Qëndresa Qytetare” dhe denoncimi **nr. 285 ID**, me kërkues shoqatën “Komiteti Shqiptar i Helsinkit”. Të ndodhur në kushtet, që administrata e Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve kishte nisur hetimin në lidhje me rastin e pretenduar nga të dy këta denoncues, bashkisë Korçë i është njoftuar administrimi i këtyre dy denoncimeve dhe i është kërkuar informacion, përse pretendohet nëpërmjet email të datës 13.4.2023.

Nëpërmjet e-mail të datës **14.4.2023** bashkia Korçë ju është përmbajtur pretendimeve të dërguara në e-mail e datës 6.4.2023.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 25.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Të pranishëm në këtë seancë ishin përfaqësuesi i autorizuar i qendres “Qëndresa Qytetare” dhe përfaqësuesi i autorizuar i organizatës “Komiteti Shqiptar i Helsinkit”, ndërsa nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Korçë.

Në seancën publike, përfaqësuesit e respektivë të palëve denoncuese mbështetën edhe një herë qëndrimin e tyre sipas denoncimit të depozituar si dhe theksuan edhe një herë se përdorimi i ambienteve të Qendrës Sportive Korçë përbën shkelje të parashikimeve ligjore në fuqi, pasi përdorimi i burimeve publike për qëllime zgjedhore nuk mund të legjitimohet në asnjë rast.

Në përfundim të hetimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve, rezultoi se:

I.

Aktiviteti i mësipërm është aktivitet politik dhe bashkia Korçë ka gabuar në raportimin e këtij aktiviteti. Aktiviteti ka pasur për objekt “*Takim prezantues me asamblenë e zgjeruar*” dhe është raportuar në ndërfaqe më datë 31.03.2023 dhe planifikohej për t’u organizuar më datë 01.04.2023.

Referuar pikës 1, të nenin 92 të Kodit Zgjedhor **“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”** detyrimi për raportim rëndon vetëm **mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore**. Në këtë rast vlerësohet se aktiviteti i mësipërm nuk është aktivitet institucional dhe si i tillë nuk duhej të raportohet nga bashkia Korçë. Megjithatë, për aq kohë sa një aktivitet, qoftë ky dhe politik, raportohet pranë ndërfaqes së raportimeve, si një aktivitet institucional (kujtojmë se të drejtën për të raportuar e kanë vetëm institucionet publike), për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kjo vlerësohet si shkelje administrative dhe për pasojë është vendosur ndalimi i këtij aktiviteti.

Vihet re se pas daljes me vendim për ndalimin e zhvillimit të aktivitetit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bashkia Korçë edhe pse ka marrë dijeni për këtë ndalim nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ankimimin apo vënien në dijeni të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi organizatorin e aktivitetit të planifikuar për të zhvilluar. Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, rezultoi se z. Sotiraq Filo, kryetar i bashkisë Korçë ka zhvilluar aktivitetin e ndaluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pavarësisht marrjes dijeni për ndalimin e veprimtarisë.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se zhvillimi i këtij aktiviteti të ndaluar për tu planifikuar nga bashkia Korçë, përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

II.

Denoncuesi pretendon se aktiviteti i mësipërm, është kryer në ambiente publike dhe që administrohen nga bashkia Korçë.

Referuar pikës 1 dhe 2, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor **“1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme**

dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson si të drejtë pretendimin e palëve se ambientet e përdorura, për kryerjen e një aktiviteti politik, janë në pronësi publike dhe si të tilla nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje. Megjithatë, vetë dispozita parashikon mundësinë e **“rasteve të parashikuara nga ligji”** kur mund të lejohet përdorimi i burimeve publike. Ambientet, që për shkak të funksionit dhe mundësive akomoduese që ofrojnë dhe kur dhënia në përdorim, bëhet sipas kushteve dhe kritereve të caktuara, mund të përdoren nga subjektet zgjedhore. Qendra sportive ku është zhvilluar aktiviteti elektoral është “shoqëri aksionare” dhe 100% e aksioneve zotërohen nga bashkia Korçë. Referuar nenit 2 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, karakteri tregtar i një shoqërie përcaktohet **nga forma** ose **objekti** i saj. Shoqëritë anonime janë tregtare **për shkak të formës së tyre**. Sipas objektit, ambientet e qendrës sportive Korçë, mund të përdoren **për çdo lloj** aktiviteti. Ligji i posaçëm prevalon në zbatimin e tij me dispozitat e përgjithshme siç është Kodi Zgjedhor. Në këto kushte, për aq kohë sa nuk ka favorizim për dhënien në përdorim të këtyre ambienteve, për subjektet zgjedhore, vlerësoj të përligjur përdorimin e këtyre ambienteve.

Përsa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet procedimi administrativ për sa i përket përdorimit të ambienteve të “Qendrës Sportive Korçë” nuk përmban fakte dhe rrethana që përbëjnë shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenin 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë ndaj z.Sotiraq Filo, kryetar i bashkisë Korçë në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë ndaj zj. Mariana Jorgji, person përgjegjës për raportimin e veprimtarisë publike në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë.

Data: 25 Prill 2023

Nr: 412
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj kryetarit të bashkisë Korçë dhe personit përgjegjës në bashkinë Korçë”

3. Pushimin e hetimit administrative dhe moskonstatimin e shkeljes për z. Luis Qirinxhi, administrator i “Qendra Sportive Korçë” sh.a .
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 4
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
I.Horanlliu _____
M.Koja _____
A. Lamçe _____
Y.Merkaj _____